



Titulli i projektit

Pastrimi i lumit Ishëm

Tipi i projektit

Zhvillim Ekonomik

Vendndodhja e projektit

Ishëm

Buxheti i paravlerësuar

37,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Lumi Ishëm (74 km) kalon në pjesën qendrore të Shqipërisë dhe derdhet në Kepin e Rodonit, njësi administrative Ishëm. Në lumin Ishëm grumbullohen mbeturina të llojeve të ndryshme (si p.sh.: industriale, teknologjike, bujqësore, ushqimore, ujërat e zeza, etj.), që sjellin 3 lumenj të tjerë: lumi i Tiranës, përrënjtë Tërkuza dhe Zeza. Këto mbeturina shkaktojnë ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Dihet që ndotja e ujit të lumenjve ka një ndikim të drejtëpërdrejtë negativ në shëndetin e banorëve që e përdorin, apo që jetojnë në zonat përreth, si dhe në ekosistemin e lumit, i cili bën shpeshherë pastrimin e ujit.

Mbi të gjitha, Ishmi sjell tonelata me mbetje që derdhen dhe depozitohen në bregun e detit dhe që ndikojnë negativisht edhe në turizëm.

Qëllimi/et specifik të projektit

Qëllimi i projektit është përmirësimi i cilësisë së ujit të lumit Ishëm dhe ulja e volumit të mbetjeve që derdhen në Adriatik. Kjo do të shërbejë në përmirësimin e cilësisë së ambientit në këtë njësi administrative dhe në gjithë ZF.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- (a) përmirësimin e cilësisë së ujit të lumit Ishëm;
- (b) përmirësimin e kushteve mjedisore në njësinë administrative dhe në Zonën Funksionale
- (c) përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të zonës;
- (d) rritja e pastërtisë dhe cilësisë së bregut të detit dhe rritja e atraksionit turistik të të gjithë zonës bregdetare.

Pastrimi i lumit Ishëm do të ndikojë në cilësinë e jetës së 5000 banorëve të Ishmit, të banorëve të njësi administrative fqinje dhe të turistëve që vijnë të përfitojnë nga bregu i detit. Numri i njësi administrative që përfitojnë nga kjo ndërhyrje është 2-3 (dy-tre).



Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt e projektit është rreth 3-4 muaj.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë:

- (a) vlerësimin e treguesve të ndotjes fizike, kimike dhe biologjike;
- (b) vlerësimin teknik dhe financiar të nevojave për ndërhyrje;
- (c) kryerjen e pastrimit të ujit të lumit;
- (d) aktivitetet ndërgjegjësuese për mbrojtjen e ujit të lumit në njësinë administrative Ishëm dhe ato fqinje.

Ky aktivitet parashikon ndërhyrjen në të gjithë lumin dhe në atë të tributarëve të tij: Tërkuza dhe Zeza, që ndodhen jashtë kufijve të Bashkisë së Re Durrës. Në një situatë të tillë duhet të koordinohet me njësitë e tjera vendore.

Maturimi i projektit

Parashikohet të kryhet një vlerësim i situatës aktuale dhe shkallës së ndotjes së lumit Ishëm dhe identifikimi i nevojave për ndërhyrje.

Mënyra më e mirë për ta bërë këtë aktivitet do të ishte me ndërhyrje vullnetare dhe me sensibilizim të komuniteteve që jetojnë buzë lumit dhe tributarëve të tij.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burime të mundshme financimi janë skemat e parashikuara për përmirësimin e mjedisit të donatorëve, si BE, GIZ, fondi i Ministrisë së Mjedisit, Bashkia Durrës, etj..

Partnerë të mundshëm në zbatimin e këtij projekti janë Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Bashkia Durrës, etj..

Kostot e projektit

Kostot janë në funksion të modelit (biznes apo vullnetar) të aksionit, por mund të shkojnë në rreth 37,000 Euro.